

## NJOFTIM

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2026 është i disponueshëm në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit [https://akm.gov.al/ova\\_doc/programi-kombetar-i-monitorimit-te-mjedisit-2026/](https://akm.gov.al/ova_doc/programi-kombetar-i-monitorimit-te-mjedisit-2026/).

Në mbështetje të VKM Nr 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, ftojmë të gjithë palët e interesuara shtetërore (institucione/universitete) që kryejnë analizime të treguesve mjedisorë bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2026, të dërgojnë projekt-propozime pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Përjashtim bëjnë treguesit e mëposhtëm të cilët monitorohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit:

- Ujëra sipërfaqësore (lumenj, liqene), dhe bregdetare (laguna, zona bregdetare) analizohen parametrat; temperatura, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO<sub>5</sub>, TOC, nitritet, nitratet, amonjaku, P<sub>total</sub>, PO<sub>4</sub>, lënda pezull.
- Tregues që analizohen vetëm në liqene; transparenca, klorofila-a, indeksi trofik TSIC.
- Matja e nivelit të zhurmave (Laeq).
- Treguesit e cilësisë së ajrit urban: PM<sub>10</sub>, PM<sub>2.5</sub>, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO dhe BTEX